

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED] nga Ferizaj Rr.” [REDACTED]” nr.11, kundër të paditurës [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], lidhur pagimin e të ardhurave personale pas pensionimit, me datë 04.07.2016, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] nga Ferizaj Rr.” [REDACTED]” nr. [REDACTED], e ushtruar kundër të paditurës [REDACTED], [REDACTED] me anë të së cilës ka kërkuar që e paditur t’ia paguaj paditëses tri paga mujore pas pensionimit në shumë prej 984.00 Euro dhe dy paga jubilarë në shumë prej 656.00 Euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

Arsyetimi

Paditësja me datë 17.12.2013, ka parashtruar padi kundër të paditës, lidhur me pagimin e tri pagave mujore pas pensionimit në shumë prej 984.00 Euro dhe dy pagave jubilarë në shumë prej 656.00 Euro.

Pretendimet e palëve ndërgjyqësore

Paditësja ka qenë në marrëdhënie pune që nga viti 1968 deri në vitin 2013 në arsim, në shkollën fillore “[REDACTED]” në Ferizaj, si arsimtare e matematikës 1968-1970, në institucionin shkollor “[REDACTED]” në Ferizaj, si edukatore nga viti 1970-1993, në shkollën fillore “[REDACTED]”, si edukatore nga viti 1993-1999, si dhe në institucionin parashkollor “[REDACTED]” nga viti 1999-2010 si drejtoreshë dhe në fund edukatore nga viti 2010-2013. I ka propozuar Gjykatës që të paditurën t’ia detyron t’ia paguaj paditëses tri paga mujore pas pensionimit në shumë prej 984.00 Euro dhe dy paga jubilarë në shumë prej 656.00 Euro.

E paditura përmes të autorizuarit të saj deklaroj se kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë juridike, sepse me kontratën e punës nuk është paraparë shpërblimi për pagesën e pagave jubilarë dhe tri pagave për shkuarje në pension. Paditësja është pensionuar me datë 28.10.2013, kur kontrata kolektive nuk ishte në fuqi. I propozojë Gjykatës t'a refuzonë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sër provash: Vërtetimi i datës 16.12.2013; Kontrata e punës për edukatore e datës 13.12.2011; Refuzimi i kërkesës i datës 11.11.2013; Vendimi mbi njohjen e të drejtës në pension i datës 23.10.2013.

Nga provat e admisnitruara më lartë Gjykata vërtetoi faktin se paditësja është pensionuar me datë 07.10.2016, nga kjo shihet se në kohën kur ka dalur në pension paditësja nuk ka qenë në fuqi kontrata kolektive, por ka qenë në fuqi Ligji i Punës të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-212, i cili në nenin 2.1 parashe "Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovë". Në nenin 3.1.3 parashihet se "Sektori publik - sektori i arsimit, të shëndetësisë si dhe ndërmarrjet publike të cilat janë pronësi e Republikës së Kosovës apo e ndonjëres nga komunat e Republikës së Kosovës". Me këtë ligj nuk parashihet e drejta e punëtorit të pensionuar në realizimin e të drejtës në pagesën në emër të shpërblimit jubilar dhe pagesën përcjellëse pas pensionimit. Paditëses i ka pushuar marrëdhënia e punës sipas fuqis ligjore me rastin e pensionimit. Andaj Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditësit është e pabazuar.

Andaj nga të theksuarat e më lartë, e duke u bazuar në nenet 143 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.900/13, me datë 04.07.2016

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKANE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
FERIZAJ I UROSEVAC

02.12.2016



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e nesërme pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi